




Pranuar / Dorezuar Prilbena/Protolato Received/Delivered	11.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHËRBIMIN CIVIL	1303	2022	119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.107/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.107/2022 të datës 10.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

[redacted] Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.107/2022 e datës 10.02.2022 e parashtruar nga ankuesi

II.Mbetet në fuqi Vendimi DM 213/2022 i datës 20.01.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] nëpunës civil në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (*tani e tutje referuar si AKP*), me datë 10.02.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 652/2022 të regjistruar me numër A.nr.107/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi DM 213/2022 të datës 20.01.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të AKP-së, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe Aplikimit të gabuar të se drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.02.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të AKP-së, ndërsa me datë 28.02.2022 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 10.02.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 14.12.2021 i Zëvendës Drejtorit Menaxhues; Kërkesa e ankuesit e datës 23.12.2021; Vendimi i datës 20.01.2022 i Zëvendës Drejtorit Menaxhues; Akt emërimi i ankuesit; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Vendimi i datës 19.09.2014; Kërkesa e ankuesit e datës 17.11.2021 për kthim në vend të punës; Aktvendimi PKR.NR.130/16 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special i datës 08.11.2021; E-mail i datës 28.02.2022 dhe i datës 23.12.2021; Urdhër Obligimi për Pagesë me numër të referencës 23921830; e-mail i datës 24.12.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit

është e pa bazua, sepse

Bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimin me Numër Reference 190/DL 1 të datës 05.08.2014 është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në vendin e punës *Drejtor i Departamentit Ligjor* në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore në AKP, me datë 19.09.2014 përmes Vendimit me numër protokollit 7206 dhe numër reference 07/2014 ankuesit i ka shqiptuar masën e Pezullimit Parandalues me 50% të pagës, nga data 19.09.2014 deri në marrjen e vendimit përfundimtarë nga organet kompetente, me arsyetimin se ndaj të njëjtit janë duke u zhvilluar hetime penale.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti Special, me datë 08.11.2021 ka nxjerr Aktvendimin me numër PKR.nr.130/16 me të cilin aktvendim ka pushuar procedurën penale ndaj ankuesit për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale që shkakton përjashtimin e ndjekjes penale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 17.11.2021 përmes shkresës me numër protokollit 4591 i është drejtuar Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues, dhe Menaxherit të Burimeve Njerëzore të AKP-së me kërkesë për kthim në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues të AKP-së, me datë 14.12.2021 ka nxjerr Vendimin me numër DM1243/2021 përmes të cilit ka shfuqizuar Vendimi me numër 07/2014 të datës 19.09.2014 për pezullim parandalues të ankuesit, dhe rrjedhimisht ankuesit sipas këtij vendimi nga data 15 dhjetor 2021 i është njohur e drejta e rikthimit në pozitën e mëparshme të vendit të punës Drejtor i Departamentit Ligjor sipas Akt Emërimin me Numër Reference 190/DL 1 të datës 05.08.2014, si dhe e drejta e realizimit të 50% të pagesë për periudhën kohore gjatë të cilës ankuesi nuk e kishte realizuar për shkak të pezullimit parandalues. Sipas provave të administruara, pas nxjerrjes së Vendimit me numër DM1243/2021 të datës 14.12.2021, ankuesit me datë 21.12.2021, përmes Urdhër Obligimit për Pagesë me numër të referencës 23921830 i është bërë kompensimi i 50% të pagesë për periudhën kohore gjatë të cilës i njëjti nuk e kishte realizuar për shkak të pezullimit parandalues.

Ankuesi, me datë 23.12.2021, përmes kërkesës me shkrim drejtuar punëdhënësit ka kërkuar pagesën e kamatës ligjore për pagesën e 50% të pagës gjatë kohës së pezullimit parandalues dhe pagesën e pushimeve vjetore nga viti 2014-2021.

Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues të AKP-së pas shqyrtimit të kërkesës së datës 23.12.2021, me datë 20.01.2022 ka nxjerr Vendimin me numër DM 213/2022 me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit në lidhje me pagesën e kamatës ligjore për pjesën e 50% të pagës gjatë periudhës së pezullimit si dhe kërkesën për pagesën e pushimit vjetor gjatë periudhës së pezullimit.

Kundër Vendimit me numër DM 213/2022 të datës 20.01.2022, ankuesi me datë 10.02.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe Aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës lidhur me pagesën e kamatës ligjore prej 8% për pjesën e 50% të pagës gjatë periudhës së pezullimit parandalues si dhe pagesën e pushimit vjetor nga data 19.09.2014 deri me datë 15.10.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit analizoje dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 69 ku përcaktohet se: *1. Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. 3. Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësit civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi, dhe rrjedhimisht konstatoi se pretendimi ankimor lidhur me pagesën e kamatës ligjore prej 8% për pjesën e 50% të pagës gjatë periudhës së pezullimit parandalues nuk është i bazuar sepse çështja e pezullimit parandalues për nëpunësit civil ka qenë e rregulluar në mënyrë specifike me dispozitat e nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe se organi i punësimit pezullimin e ankuesit e ka bërë në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore. Organi i punësimit pas pushimit të shkaqeve të cilat e kanë sjellë pezullimin parandalues, i ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore dhe e ka shfuqizuar vendimin për pezullim parandalues të ankuesit, duke kthyer të njëjtin në vendin e tij të punës dhe ankuesit i ka kompensuar edhe humbjet në pagë, gjegjësisht 50% të pagës të cilën ankuesi nuk e kishte realizuar gjatë periudhës së pezullimit parandalues, ashtu siç përcaktohet me nenin 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu shqyrtoj edhe pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e pushimeve të pashfrytëzuara për periudhën kohore nga data 19.09.2014 deri më datë 15.10.2021, periudhe kjo kur ankuesi ishte i pezulluar nga puna, dhe rrjedhimisht konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar sepse çështja e pushimit vjetor është e rregulluar me dispozitat e nenit 39 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *Gjatë çdo viti kalendarik, nëpunësi civil ka të drejtë në pushim vjetor me pagesë me kohëzgjatje minimale prej tetëmbëdhjetë (18) ditë pune, në shkallën prej një ditë e gjysmë (1.5) për çdo muaj kalendarik të punësimit, andaj meqenëse ankuesi gjatë periudhës së pezullimit nuk ka qenë duke ushtruar detyrat dhe përgjegjësit e punës, Kolegji vlerëson se i njëjti nuk ka mundur të fitojë, gjegjësisht akumulojë pushim vjetor ashtu siç pretendon i njëjti. Për me tepër, duke iu referuar nenit 39 paragrafi 7 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji konstatoi se pushimi vjetor nuk mund të*

shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar. Përrjashtimisht, pushimi vjetor mund t'i kompensohet nëpunësit civil në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, siç parashihet me dispozitat e nenit 5 paragrafit 8 të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, mirëpo në rastin konkret kemi të bëjmë me pezullim të përkohshëm nga marrëdhënia e punës, dhe jo me ndërprerje të marrëdhënies së punës, kështu që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensimin e pushimit vjetor edhe nëse ankuesi do të kishte pushim vjetor të pashfrytëzuar.

Andaj, bazuar si me lartë Kolegji vlerëson se Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues të AKP-së me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër DM 213/2022 të datës 20.01.2022 me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit në lidhje me pagesën e kamatës ligjore për pjesën e 50% të pagës gjatë periudhës së pezullimit si dhe kërkesën për pagesën e pushimit vjetor gjatë periudhës së pezullimit, ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.107/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Zëvendës Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Menaxheres së Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

